VENDIM
Nr. 319, datë 28.5.2014

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, FAZA III, TË BASHKISË SË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, faza III, të Bashkisë së Fierit.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Fierit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen sipas masës së dhënë në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 9 532 (nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) m², tokë arë, në vlerën 9 532 000 (nëntë milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 532 000 (nëntë milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Fierit, planifikuar në buxhetin e saj.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Fierit.
6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas miratimit të projektit.
7. Regjistrimi i ri i pasurisë, për sipërfaqen 9 532 (nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) m², tokë arë, bëhet në favor të Bashkisë së Fierit.
8. Afati i përfundimit të punimeve të objektit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Fierit.
9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia e Fierit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE, FAZA E III, NË BASHKINË E FIERIT

Nr.	**Emër, mbiemër**	**Sip. tokë arë m^2**	**Çmimi lekë/m^2**	**Vlera lekë**	**Numri i pasurisë**	**Zona kadastrale**	**Dok. i pronësisë**
1	Iljaz Qazim Hoxha	3932 600	1000 1000	3 932 000 600 000	288/127 288/129	2637 2637	 Certifikatë pronësie
2	Ibrush Riza Hoxha	5000	1000	5 000 000	288/52	2637	Certifikatë pronësie